

Fabio Capanni është Profesor ilëndësKompozicioni Arkitektonike dhe Urbane në DIDA, Departamenti i Arkitekturës në Universitetine Firences, ku u doktoratua në vitin 2000 me temën me titull "Disa lloje të arkitekturës italiane".

Është Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë.

Është anëtar i Jurisë dhe anëtar i Kolegjit të Doktoratës në "Dizajn Arkitekturor dhe Urban" në DIDA. Ka qenë pedagog i lëndës *Karakteret shpërndarëse dhe arredim* në Masterin Teologji dhe Arkitekturë të Kishave në Fakultetin Teologjik të Italisë Qendrore. Është anëtar i Komitetit Shkencor të Identitetit të Konferencës së Arkitekturës Italiane që zhvillohet çdo vit në Firence. Në vitin 2009 ai themeloi, së bashku me Paolo Zermani, Galerinë e Arkitekturës Italiane në Firence.

Ka bashkëpunuar me revistën ndërkombëtare *Materia* dhe ishte redaktor i revistës ndërkombëtare *Area*; aktualisht ai është anëtar i Komitetit Shkencor të revistës *Firenze Architettura*. Është autor i: *Arkitektura Moderne në Fiesole* (Becocci, 2003); *Disa figura dhe karaktere të ndërtimeve të banesave në Toscana në horizontin e qëndrueshmërisë* (Noédizioni, 2008); *Hapësira, Drita, Arkitektura* (Noédizioni, 2009); *Forma e dritës* (Noédizioni, 2015); *Arkitektura dhe Drita* (LetteraVentidue, 2017) dhe artikuj dhe ese të shumta.

Drejtor i publikimeve *Lumina* për *LetteraVentidue*, ku trajtohen raportetmes dritës natyrore dhe arkitekturës dhe është drejtori shkencor dhe bashkëthemelues i *ReThink Daylight*, projekt ndërkombëtar për të promovuar rolin e dritës natyrore në arkitekturë, promovuar nga *Velux*.

Drejtues shkencor i workshopit ndërkombëtar *Spazio, Luce, Architettura*, promovuar nga *Casabella Formazione* dhe *Velux*, ku kishte si pedagogë: Manuel Aires Mateus, José Ignacio Linazasoro, Jesus Leache, Alvaro Siza, Francesco Dal Cò, Federico Bucci, Marco Mulazzani, etj. Maria Bonaiti.

Aktiviteti i projektit ka qenë gjithmonë fusha e privilegjuar e zbatimit të rezultateve të hulumtimit teorik të përqendruar në studimin e marrëdhënies midis dritës natyrore dhe hapësirës arkitektonike, dhe ka çuar në krijimin e veprave të publikuara në revista të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, ndër këto: *Palestra "La Fonte"* në Sesto Fiorentino (Firence); *Piazza Don Formelli* në Pian di Mugnone në Fiesole (Firence); *Seksioni Arkeologjik i Muzeut të S. Agostino* në Montalcino (Siena); *Kapela e Couvente des Lazaristés* në Jeruzalem; *Zgjerimi i shkollës fillore-të mesme Stefanacci* në San Piero a Sieve (Firence); *Ristrukturimi dhe shtrirja e ish-Fakultetit të Drejtësisë* (Firence); *Zgjerimi i kopshteve të Tagliaferros* në San Piero a Sieve (Firence).